



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

KOMISIONI HETIMOR
PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE TË SISTEMIT TIMS

Tiranë, më _____._____.2024

DEKLARIMI I PLANIT PARAPRAK TË HETIMIT

Në mbështetje të paragrafit 4, të nenit 11 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, ku specifikohet se: “4. Kryetari deklaron qëllimin e ngritjes së komisionit, përcakton detyrat e komisionit, si dhe planin paraprak të hetimit”, bashkëlidhur do të gjeni Planin Paraprak të Hetimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PLANI PARAPRAK I HETIMIT

I KOMISIONIT HETIMOR PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE TË SISTEMIT TIMS

I. FAKTET DHE RRETHANAT E PREZANTUARA NË KËRKESË

Në kërkesën e depozituar nga 1/4 e deputetëve evidentohet se:

Në 11.04.2021, media online publikoi lajmin se Partia Socialiste e Shqipërisë kishte krijuar një bazë të dhënash personale për 910 mijë qytetarë të Tiranës. Kjo bazë përfshinte të dhëna për emrin, atësinë, mbiemrin, numrin e identitetit, numrin e telefonit, adresën e shtëpisë, vendin e punës dhe bindjet politike. Kjo bazë të dhënash menaxhohej nga të ashtuquajturit “patronazhistë”, të cilët ishin anëtarë apo aktivistë të Partisë Socialiste, dhe njëkohësisht mbanin funksione të caktuara në administratën publike. Konkretisht, 9027 patronazhistët e identifikuar rezultojnë të punësuar në administratën publike, qendrore dhe vendore, Gardën e Republikës, Forcat e Armatosura dhe Policinë e Shtetit.

Kjo bazë të dhënash u shpërnda masivisht në platforma të ndryshme publike, në shkelje flagrante të legjislativës shqiptare për të dhënat personale. Qytetarë të shumtë, të dhënat personale të të cilëve u publikuan, konfirmuan faktin se ata nuk i kishin dhënë asnjëherë miratimin Partisë Socialiste për të kryer mbledhjen, përpunimin apo publikimin e të dhënave të tyre, dhe e vetmja mënyrë nga mund të ishin siguruar këto të dhëna ishin bazat shtetërore. Kryeministri, njëherazi kryetar i Partisë Socialiste, Edi Rama nuk e mohoi ekzistencën e kësaj baze të dhënash dhe patronazhistëve, madje në fjalime publike ai i falënderoi ata për kontributin e tyre në suksesin elektoral të PS-së.

Megjithatë, raportet paraprake dhe finale të OSBE/ODIHR, vërejtën si një nga problematikat më të mprehta të zgjedhjeve parlamentare të 25 Prillit 2021, rrjedhjen e të dhënave personale dhe sensitive të qytetarëve, duke kërkuar marrjen e masave të menjehershme për garantimin e sigurisë së tyre. I njëjti shqetësim u pasqyrua edhe në progres raportin e Komisionit Evropian për vitin 2021, i cili kërkonte nga autoritetet shqiptare ndërmarrjen e masave urgjente për të garantuar sigurinë e të dhënave personale të qytetarëve. Organizata vendase dhe të huaja, ashtu si edhe media ndërkombëtare, e konsideruan skandal të rëndë dhe shkelje të standardeve minimale të privatësisë publikimin gjërësisht të të dhënave sensitive, përfshirë bindjet politike të zgjedhësve.

Disa muaj më pas, më 21.12.2021, nëpërmjet aplikacionit Ëhatsapp u shpërndanë masivisht listat e pagave të muajve Janar dhe Prill 2021 për 637 mijë qytetarë shqiptarë. Në format “Excel”, këto lista pasqyronin pozicionin, vendin e punës dhe pagën. Edhe në këtë rast, pati një hetim nga ana e organeve të drejtësisë, i cili konkludoi me marrjen në përgjegjësi të 4 shtetasve të punësuar në institucionet tatimore që i kishin shitur listëpagesat për një shumë qesharake tek individë të paautorizuar. Megjithatë, edhe ky rast provoi qartazi se sa të dobëta dhe të pambrojtura ishin bazat e të dhënave shtetërore nga ndërhyrjet e paligjshme. Shqetësimi për menaxhimin e dobët të sigurisë në mbrojtjen e të dhënave personale në bazat shtetërore u konfirmua më tej edhe nga publikimi i bazës së të dhënave të automjeteve, në datën 24.12.2021. Kjo bazë përfshinte të dhënat e pronarit të mjetit, targat, markën dhe llojin e mjetit.

Problematika e rrjedhjes së të dhënave personale do të prekte edhe ato që konsiderohen sistemet më të sigurta dhe të mbrojtura, institucionet bankare. Në datën 09.01.2023, një grup hakerash do të publikonte të dhënat e një mijë llogarive bankare të qytetarëve shqiptarë. Konkretisht, këto të dhëna përfshinin pronarin e llogarisë, gjendjen e parave në llogari, IBAN-in, numrin e telefonit, adresën e email-it dhe adresën fizike. **Por, ndër ngjarjet më të rënda që kërkoi vëmendjen dhe ndërhyrjen urgjente të Parlamentit mbeten ndërhyrjet e paligjshme në sistemin TIMS, për të cilat Agjencia e Mbikëqyrjes Policore bëri një kallëzim penal ndaj Forcës Operacionale.**

Kjo çështje mori edhe vëmendjen e të Ngarkuarit me Punë të Ambasadës Amerikanë në Tiranë, Z. Martin McDoëll, i cili gjatë një takimi me ministrin e Brendshëm, shprehu shqetësimin e SHBA-ve në lidhje me ndërhyrjen e raportuar në sistemet TIMS në Policinë e Shtetit dhe kërkoi një hetim të shpejtë dhe të gjithëanshëm, duke theksuar rëndësinë që ka mbrojtja e të dhënave vetjake/sensitive, përfshi edhe të qytetarëve amerikanë në Shqipëri. Ndërhyrja në sistemin TIMS, përveçse çështjes së mbrojtjes të të dhënave personale, ngre edhe problematikën e rendit dhe sigurisë në vend, pasi këto të dhëna mund të bien në duart e elementëve kriminalë.

Rastet e sipërcituara, por edhe të tjera, dëshmojnë për problematikën në rritje të mbrojtjes së të dhënave personale, vecanërisht atyre që mblidhen, përpunohen dhe publikohen nga institucionet publike. Organizata të ndryshme të shoqërisë civile dhe mediat, ku vecojmë reagimin e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në datën 25.08.2023, kanë kërkuar nga Kuvendi i Shqipërisë të ndërmarrë hapat e nevojshëm për forcimin e mbikëqyrjes parlamentare ndaj institucioneve të sigurisë dhe inkurajojnë veprime konkrete për shqyrtimin e plotë të përgjegjësive institucionale lidhur me shkeljet e përsëritura dhe parandalimin e tyre në të ardhmen.

II. PLAN PARAPRAK HETIMI

A. Objekti:

Sipas vendimit të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Trajtimin e të Dhënave të Sistemit TIMS, objekt i veprimtarisë së komisionit është:

1. Shqyrtimi i çështjeve lidhur me kontrollin e veprimtarisë së institucioneve të ngarkuara me mbrojtjen e sistemit TIMS;
2. Vlerësimi i nevojës për marrjen e masave administrative apo, ndërhyrjet ligjore në legjislacionin përkatës.

Hetimi do të synojë kontrollin e zbatimit të ligjeve në fuqi nga organet dhe funksionarët publikë, nxjerrjen e përgjegjësive institucionale dhe vlerësimin e nevojës për miratimin, shfuqizimin, ndryshimin e dispozitave të kuadrit ligjor në fuqi, me qëllim garantimin e standardeve më të larta të sigurisë dhe mbrojtjes për të bazat e të dhënave të sistemit TIMS.

Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, vecanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë, parimin për një proces të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e paanshmërisë dhe i respektimit të jetës private të individit.

Hetimi do të realizohet në drejtim të sqarimit të mënyrës së zbatimit të ligjit, identifikimit të përgjegjësive të organeve apo personave zyrtarë të ngarkuar me administrimin, sigurinë dhe mbrojtjen e sistemit TIMS, analizimit të gjetjeve për të përgatitur rekomandimet për ndërhyrje ligjore e administrative për parandalimin apo eliminimin plotësisht të shkeljeve ligjore në të ardhmen.

Konkretisht, hetimi do të përqendrohet:

- i) Cili është kuadri ligjor që rregullon mënyrën e administrimit, mbrojtjes dhe sigurisë së bazës së të dhënave të sistemit TIMS?
- (ii) A ka pasur shkelje të këtij kuadri ligjor nga personat e autorizuar për administrimin, mbrojtjen dhe sigurinë e këtij sistemi?
- (iii) Cilët kanë qenë organet dhe funksionarët publikë të ngarkuar me administrimin, mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave të sistemit TIMS?
- (iv) Si i kanë kryer këto organe/funksionarë detyrat që iu ngarkon Kushtetuta, ligji dhe aktet nënligjore?
- (v) A kanë kryer shkelje? Nëse po, cilat janë këto shkelje dhe cilat janë arsyet/motivet që këto subjekte kanë vepruar në shkelje të Kushtetutës, ligjit dhe/ose akteve nënligjore?

B. Detyrat e Komisionit dhe veprimet e tij:

Detyrat e Komisionit janë:

- (1) Kontrolli i veprimeve a mosveprimeve të organeve dhe funksionarëve publik të ngarkuar me administrimin, mbrojtjen dhe sigurinë e bazës së të dhënave të sistemit TIMS;
- (2) Verifikimi i shkeljeve ligjore të kryera dhe pasojave që kanë pasur këto shkelje për sigurinë e të dhënave personale të qytetarëve shqiptar dhe të huaj;

- (3) Vlerësimi i nevojës për ndërhyrje ligjore, me qëllim që të garantohet mbrojtja e të dhënave personale të qytetarëve shqiptarë dhe të huaj, si dhe aplikimi i standardeve më të larta të sigurisë për një bazë të dhënash tejet sensitive;
- (4) Përgatitja e rekomandimeve për marrjen e masave administrative dhe ligjore, si dhe në rast se konstatohet kryerja e veprave penale, njoftimi i prokurorisë për fillimin e çështjes penale.

Për përmbushjen e këtyre detyrave, komisioni:

- 1) miraton planin e hetimeve;
- 2) mbledh të dhëna për çështjen, të cilat mund të jenë informacione zyrtare dhe jozyrtare, por që njihen publikisht;
- 3) thërret dëshmitarë për të sqaruar rrethana të ndryshme që lidhen me çështjen;
- 4) në shërbim të hetimeve mbi çështjen, administron dokumente zyrtare, si dhe të dhëna të tjera që ndihmojnë në zhvillimin e hetimeve;
- 5) për të sqaruar rrethana të ndryshme që lidhen me çështjen, thërret ekspertë të njohur nga gjykata për fusha të ndryshme.

Në mbështetje të neneve 14/b, 15/1 dhe 17 të ligjit nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë Për Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Trajtimin e të Dhënave të Sistemit TIMS, do të kërkohet nga disa institucione shtetërore, që të vendosin në dispozicion informacionet/dokumentat që disponojnë për objektin e hetimit. Konkretisht, do të kërkohen ndër të tjera, por pa u kufizuar vetëm në to, dokumentet apo informacionet e mëposhtme:

1. Informacione dhe dokumente nga Kryeministria, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Shërbimi Informativ Shtetëror, Prokuroria e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Trupi Diplomatik i akredituar, lidhur me mënyrën e trajtimit, administrimit, mbrojtjes dhe sigurisë së të dhënave të sistemit TIMS;
2. Çdo informacion tjetër të nevojshëm për përmbushjen e detyrave nga ana e Komisionit, sipas objektit të punës së Komisionit.

Komisioni Hetimor përveç marrjes së informacioneve zyrtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të përdorë të gjitha metodat e hetimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, përfshirë kqyrjen, kontrollin apo sekuestrimin e akteve pranë institucioneve përgjegjëse. Komisioni do të administrojë të gjitha raportet që i referohen çështjeve, që janë objekt i veprimtarisë së tij.

Komisioni rezervon të drejtën, që në përputhje me nevojat që do të dalin gjatë hetimit, si dhe bazuar në nenin 18 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, të caktojë ekspertë ligjorë, të sigurisë, kibernetikë etj.

Nga ana tjetër, në kuadër të analizës së plotë mbi këtë çështje, do të thirren për të dëshmuar në Komisionin Hetimor, personat apo funksionarët publik të mëposhtëm:

Emër, Mbiemër	Funksioni
Edi Rama	Kryeministër i Shqipërisë
Taulant Balla	Ministër i Brendshëm
Muhamet Rrumbullaku	Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit
Florian Sulejmani	Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore
Bledar Cuci	Ish-Ministër i Brendshëm
Gledis Nano	Ish-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit
Ardi Veliu	Ish-Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore
Vlora Hyseni	-Kryetare, Shërbimi Informativ Shtetëror
Olian Kanushi	Ish-Kryetar SHISH
Ferdinand Dervishi	Gazetar
Zef Laska	Drejtor i Burimeve Njerëzore Policia e Shtetit
Neritan Nallbati	Drejtor i Departamentit të Policisë Kriminale
Dorjan Tola	Drejtor i AKSIK
Ervin Muca	Drejtor i Departamentit të IT, Policia e Shtetit
Ervina Gjana	Drejtor i Krimit Kibernetik
Besjon Tanuzi	Ish Drejtor i Sistemeve, Policia e Shtetit
Enri Ndoni	Drejtor i Sistemeve, Policia e Shtetit
Ardit Muca	Shef i sektorit IT, Policia e Shtetit
Eraldin Ndreca	
Ardit Muca	
Enkli Hoxha	
Ergis Hidri	
Ljubica Dervishaj	

Xhuljeta Collaku	
Albana Vrapı	
Arben Babaj	
Hergis Jica	
Elvis Hysi	
Ermal Beqiri	
Nevila Xoxa	
Kompania “Soft”	
Kompania “Horizont”	
Sali Berisha	Ish Kryeministër, shtuar në planin paraprak si propozim i anëtares së Komisionit Hetimor, Znj. Blerina Gjylameti
Lulzim Basha	Ish- Ministër i Brendshëm, shtuar në planin paraprak si propozim i anëtares së Komisionit Hetimor, znj. Blerina Gjylameti
Gazmend Bardhi	Kryetar i Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike, shtuar si propozim i nënkryetarit të Komisionit Hetimor, Z. Toni Gogu
<p>- Komisioni rezervon të drejtën që ne Planin e Hetimit të thërrasë për të dëshmuar cdo person apo funksionar tjetër që ka dijeni rreth objektit të hetimit, dhe që rezulton i përfshirë në këtë çështje nga shqyrtimi i dokumentacionit zyrtar.</p>	

C. Afati i zhvillimit të hetimeve dhe përfundimit të tij:

Veprimet	Afati maksimal
Mbledhja e dokumentacionit	Brenda datës 10 Prill 2024
Shqyrtimi paraprak i dokumentacionit dhe vlerësimi i nevojës për dokumentacion shtesë – Miratimi i Planit të Hetimit	Brenda datës 20 Prill 2024

Pyetja e dëshmitarëve	Brenda datës 5 Qershor 2024
Analizimi i akteve dhe dokumentave	Brenda datë 20 Qershor 2025
Shqyrtimi përfundimtar dhe nxjerrja e konkluzioneve të hetimit – Mbyllja e Hetimit	Brenda datës 5 Korrik 2024
Prezantimi i Raportit Final të Komisionit	Brenda datës 15 Korrik 2024.

Hetimi konsiderohet i hapur dhe Komisioni do të përfundojë veprimtarinë e tij brenda afatit të caktuar me vendim të Kuvendit (21 Korrik 2024)

D. Hartimi i Planit të Hetimit:

Mbi bazën e Planit Paraprak të Hetimit dhe propozimet e ekspertëve ligjorë, Kryetari i propozon Komisionit për miratim projektvendimin “Për miratimin e Planit të Hetimit të Komisionit Hetimor” brenda afateve të parashikuara nga ligji. Me qëllim hartimin e Planit të Hetimit dhe realizimit të veprimeve të përcaktuara në këtë Plan Paraprak Hetimi, Komisioni, nëpërmjet Kryetarit, mund të kërkojë të dhëna dhe dokumente të tjera nga titullarët e institucioneve publike, si dhe të kryejë cdo veprim sipas nenit 15 dhe 17 të ligjit nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”.

KRYETARI

Ervin SALIANJI